



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

DATË/A:	19.01.2015
REFERENC-Ë:	AKK- DPK- DPKPP
PËR/ZA/TO:	z. Abdurrahman URUÇI Udhëheqës i Zyrës së Prokurimit në Komunën e Ferizajt
CC:	z. Muharrem SVARQA Kryetar i Komunës së Ferizajt
NGA/OD/FROM:	z. Hasan PRETENI Drejtore i Agjencisë Kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me Menaxhimin e Kontratës Publike me titull "Lot1 Furnizimi me 1 aparat të mamografisë për diagnostifikimin e kancerit të gjirit, 10 aparate për EKG dhe 5 Sterilizator për nevojat e QKMF-së Ferizaj dhe Lot 2 Furnizimi me 5 karrige Stomatologjike për nevoja të QKMF-së Ferizaj"

I nderuari z. Uruçi ,

Në mbështetje të nenit 5 paragrafi 1 nën paragrafi 1.12 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit dhe nenit 19 paragrafi 1 nën paragrafi 1.6 të Ligjit nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, lidhur me Tenderin " Lot 1 Furnizimi me 1 aparat të mamografisë për diagnostifikimin e kancerit të gjirit, 10 aparate për EKG dhe 5 Sterilizator për nevojat e QKMF-së Ferizaj dhe Lot 2 Furnizimi me 5 karrige Stomatologjike për nevoja të QKMF-së Ferizaj" me numër prokurimi: 656-14-290-121, Agjencia kundër Korrupsionit, ofron këtë:

OPINION

Në lidhje me monitorimin e Menaxhimit të Kontratës Publike me titull " Lot 1 Furnizimi me 1 aparat të mamografisë për diagnostifikimin e kancerit të gjirit, 10 aparate për EKG dhe 5 Sterilizator për nevojat e QKMF-së Ferizaj dhe Lot 2 Furnizimi me 5 karrige Stomatologjike për nevoja të QKMF-së Ferizaj" me numër prokurimi: 656-14-290-121 i iniciuar nga Autoriteti kontraktues Komuna e Ferizajt.

Arsyetimi

Agjencia kundër Korrupsionit ka qenë pjesë e monitorimit në vlerësimin e tenderit me titull “Furnizim me një aparat të Mamografisë për diagnostikimin e kancerit të gjirit, 10 aparate për EKG, 5 sterilizator dhe 5 karrige stomatologjike për nevoja të QKMF-së Ferizaj “. Me dt.08.10.2014, AKK kishte ofruar Opinion në lidhje me monitorimin e këtij procesi të prokurimit.

Agjencia kundër Korrupsionit me dt.07.10.2014, sipas detyrës zyrtare ka paraqitur Njoftim pranë Autoritetit Kontraktues Komuna e Ferizajt, përmes së cilit e ka njoftuar të njëjtin se AKK do të merr pjesë në monitorimin e Menaxhimit të Kontratës Publike me titull “Furnizim me një aparat të Mamografisë për diagnostikimin e kancerit të gjirit, 10 aparate për EKG, 5 sterilizator dhe 5 karrige stomatologjike për nevoja të QKMF-së Ferizaj “.

Me dt.10.10.2014 Autoriteti Kontraktues ka bërë Njoftimin për dhënie të kontratës për të lotët, për lot 1 Furnizim me një aparat të Mamografisë për diagnostikimin e kancerit të gjirit, 10 aparate për EKG, 5 sterilizator është shpallur fitues Operatori Ekonomik **MEDICA** me çmim prej **41,990.00**, ndërsa për lot 2 ku ka qenë e paraparë të bëhet Furnizimi me 5 karrige stomatologjike për nevoja të QKMF-së Ferizaj është shpallur fitues Operatori Ekonomik **KOMED** me çmim prej **8,880.00 €**.

Pasi, Autoriteti Kontraktues ka bërë njoftimin për dhënie të kontratës për 2 lotet, Operatori Ekonomik KOSOVA-MED me dt.20.10.2014 si palë e pakënaqur ka parashtruar ankesë në Organin Shqyrtues të Prokurimit me nr. 422/14 për lot 1 Furnizim me një aparat të Mamografisë për diagnostikimin e kancerit të gjirit, 10 aparate për EKG, 5 sterilizator. Mirëpo me dt.07.11.2014 ka parashtruar kërkesë për tërheqje të ankesës me arsyetimin se kemi të bëjmë me një aparat të rëndësishëm së veçantë dhe është fundi i vitit, andaj ka kërkuar nga Paneli Shqyrtues i OSHP-së që ta aprovoj kërkesën për tërheqje të ankesës. Paneli Shqyrtues i OSHP-së me dt.10.11.2014, pas mbajtjes së seancës ka aprovuar kërkesën për tërheqje të ankesës së Operatorit Ekonomik Kosova Med.

Autoriteti Kontraktues e ka njoftuar Agjencinë se me dt.11.11.2014 është nënshkruar Kontrata për lot 1 Furnizim me një aparat të Mamografisë për diagnostikimin e kancerit të gjirit, 10 aparate për EKG, 5 sterilizator me Operatorin Ekonomik Medica, ndërsa për lot 2 Furnizim me 5 karrige stomatologjike e ka njoftuar AKK-në se kontrata për LOT II nuk është nënshkruar për arsye se **OE "KOMED"** nga Prishtina e ka njoftuar Autoritetin kontraktues me shkrim se tërhiqet nga nënshkrimi i kontratës dhe se AK ka filluar procedurat e konfiskimit të sigurimit të tenderit, ka bërë anulimin e njoftimit për dhënie dhe kemi bërë ri tenderimin e njoftimit për kontratë për LOT II. Autoriteti Kontraktues me dt.03.12.2014 ka bërë njoftimin për dhënie të kontratës në faqen elektronike të KRPP-së për lot 2 Furnizim me 5 karrige stomatologjike (ri-tender) ku fitues i këtij loti është shpallur **NTP ANDIDENT** me çmim prej **12,900.00 €**, me këtë Operator ekonomik edhe është nënshkruar kontrata. Herën e parë ku ishte shpallur fitues i lotit 2 Operatori ekonomik KOMED, Agjencia kundër Korrupsionit ka vërejtur se çmimin që kishte ofruar ky

Operator e me të cilin çmim edhe e kishte fituar këtë lot ishte çmim nën vlerën e tregut, andaj ky Operator ekonomik, pasi e kishte kuptuar se AKK do të jetë pjesë e monitorimit të menaxhimit të kontratës ishte tërhequr dhe kishte refuzuar nënshkrimin e kontratës.

Autoriteti Kontraktues e ka njoftuar Agjencinë se me dt.17.12.2014 nga ora 11:00 do të bëhet Furnizimi me Aparaturë të Mamografisë pranë Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare në Ferizaj (QKMF). Zyrtarët e Divizionit për Parandalimin e Korrupsionit në Prokurimin Publik kanë qenë prezent në pranimin e Aparaturës në fjalë ku kanë konstatuar gjendjen faktike si në vijim:

Zyrtarët përgjegjës të DPKPP-së si dhe anëtarët e Komisionit për pranimin teknik të Mamografit me dt.17.12.2014 kanë qenë prezent në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare ku kanë konstatuar se pajisja në fjalë është pranuar në këtë Qendër. Përfaqësuesit e Operatorit Ekonomik i cili e ka bërë furnizimin me këtë pajisje së bashku me anëtarët e Komisionit pranues e kanë njoftuar Agjencinë se pranimi teknik dhe funksionalizimi përfundimtar i aparaturës do të bëhet në ditët në vijim.

Me dt.22.12.2014 është bërë pranimi teknik dhe funksionalizimi përfundimtar i aparatit të mamografisë ku në përbërjen e komisionit për pranim ishin: **1.** Dr. Hestet Shatrolli- Kryesues, **2.** Dr. Naim Çerkini – anëtarë, dhe **3.** Rexhep Jakaj- Infermier- anëtarë, dhe përfaqësuesit tjerë **4.** Drejtori i DSHMS-së Dr. Burim Karameta, **5.** Shefi i Zyrës së Prokurimit Andurrahman Uruçi, **6.** Shefi i Sektorit të Shëndetësisë në DSHMS Ibush Bakolli, **7.** Dr. Nebahate Avdiu- radiologe dy Zyrtarët e Agjencisë kundër Korrupsionit **8.** Dardan Çela dhe **9.** Faton Mehmeti, si dhe dy përfaqësuesit e Operatorit ekonomik Medica **10.** Arbër Merovci dhe **11.** Fisnik Lulaj. Komisioni për Pranim në prezencën e të gjithë personave të lartcekur konstatoi se Aparati i plotëson të gjitha Specifikimet teknike dhe kërkesat e vendosura nga Autoriteti kontraktues, andaj erdhi në përfundim se Aparati në fjalë është funksional.

Agjencia kundër Korrupsionit gjatë shqyrtimit të dokumentacionit për këtë kontratë ka vërejtur se Operatori Ekonomik MEDICA posedon Autorizim për shitje të Mamografit nga Prodhuesi General Medical Merate s.p.a (GMM), certifikatë EN ISO 13485:2012 të lëshuar nga CSO MED për General Medical Merate spa, ndërsa certifikatën CE për Diagnostic X- Ray Systems e ka nga prodhuesi Metaltronica SPA. Lidhur me këtë OE Medica ka sqaruar se Aparatin e Mamografit nuk e prodhon GMM prej së cilës e posedon autorizimin, sipas përfaqësuesit të Operatorit Ekonomik, aparatit e mamografit për Kompaninë GMM e prodhon Kompania Metaltronica, madje sipas tij në CE certifikatën të cilën e ka nga prodhuesi Metaltronica është e cekur se Metaltronica prodhon modelin e mamografit viola për prodhuesi GMM. Pra në rastin konkret EC Certifikata dhe ISO Certifikata nuk janë nga i njëjti prodhues.

Agjencia ka kërkuar sqarim nga Agjencioni për produkte dhe pajisje medicinale (AKPM) se a mund të pajiset me leje importi i njëjti Operator Ekonomik nga AKPM, përkundër se EC Certifikatën dhe ISO Certifikatën nuk i ka nga i njëjti prodhues dhe kemi pranuar përgjigjien si në vijim “ Është shqyrtuar edhe një herë dokumentacioni në bazë të së cilës është lëshuar ‘Autorizimi për import të pajisjeve medicinale’ nr. 2005/2014 me datën 24.11.2014, për

kompaninë 'Medica', i licencuar për qarkullim me shumicë të produkteve dhe pajisjeve medicinale, me numër të licencës L1/2006/05/0079 dhe është konstatuar "Duke pasur parasysh që në EC certificate 93/42 me numër 138301-2013-CE-ITA-NA 0.0, të lëshuar nga trupi notifikues DNV me datën 29.08.2013 për kompaninë 'Metaltronica SPA', ceket decidivisht se pajisja 'Viola' prodhohet për General Medical Merate S.p.A, e cila kompani është edhe shitësi i pajisjes në fjalë (proforma nr. 014438 e dates 11/11/2014), atëherë ISO certifikata 13485:2012, e lëshuar nga trupi notifikues CSQ MED numër 9124.GNM2, për kompaninë General Medical Merate S.p.A, është dokument i përshtatshëm për përmbushjen e kriterëve për lëshimin e autorizimit të importit për këtë pajisje".

Andaj duke u bazuar në dhënat të cekura si më lartë Agjencia kundër Korrupsionit konsideron se procedura e pranimi teknik dhe funksionalizimit të aparatit mamografik është zhvilluar sipas Ligjit në fuqi për Prokurimit Publik.

Në mbështetje të nenit 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Me respekt !